



Datë: 08.05.2025
Numër Protokolli: 3301/2025

A.nr.451/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.451/2025, të datës 12.03.2025, të parashtruar nga ankuesi F.R, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Jetullah Aliu, nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “*masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.451/2025, e datës 12.03.2025, e parashtruar nga ankuesi F.R.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. KDI 14/2024, i datës 13.02.2025, i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, F.R (*tutje referuar vetëm* Ankuesi), më datë 12.03.2025, përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokat Jetullah Aliu, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. KDI 14/2024, të datës 13.02.2025, të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me të cilin vendim të njëjtit i është shqiptuar masa disiplinore “*Pezullim nga pozita pa pagesë për gjashtë (6) muaj*”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës(*në*

tekstin e mëtejme referuar: ShKK), ndërsa ky i fundit me datë 25.03.2025 ka dorëzuar përgjigjen në ankesë, se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1610/2025 të datës 12.03.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Autorizimin për përfaqësim; Vendimin me Nr. KDI 14/2024, të datës 13.02.2025, të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin e datës 06.07.2024; E-mailin e datës 22.11.2024 së bashku me korrespondonim e Prokurorisë; Shkresën e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, me numër protokolli 592 të datës 08.07.2024; Dokument identifikimi i ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 25.03.2025, të ShKK-së; Kontratën e punës të datës 15.07.2020; Përshkrimin e detyrave të punës të ankuesit; Kërkesën e datës 07.08.2024 të Policisë së Kosovës; Vendimin me Nr. KDI 15/2024 të datës 13.02.2025; Inicimin e procedurës disiplinore të datës 06.07.2024; Procesverbalin e datës 24.07.2024, të ankuesit; Vendimin KD.nr.14/2024 të datës 15.08.2024; Vendimin KD.nr.014/015/016/2024 të datës 11.02.2025; E-mailin e datës 12.02.2025; Shkresat lidhur me ish të burgosurin; Procesverbalin e datës 09.07.2024, lidhur me shiqimin e CCTV, të datës 06.07.2024; Raportimi i incidentit i datës 06.07.2024; Shkresa me titull, ikja e datës 06.07.2024; Rutina Ditore (verore)-Pavijon, me numër protokolli 00438/24 e datës 01.07.2024; Raporti i ndërrimit të natës i datës 05-06.07.2024; Raporti i ndërrimit të natës i datës 06.07.2024; Raporti ditor i mbikëqyrëseve të ndërrimit të datës 05-06.07.2024 (19:00-07:00); Fleta e numërimit e datës 05-06-07.2024; Kontrollimi ditor i rrethojës; Fleta e numërimit e datës 05.07.2024; Patrolla e datës 05.07.2024 dhe datës 05-06.07.2024; Procesverbalin e datës 09.07.2024, të N.A; Procesverbalin e datës 09.07.2024, të ankuesit; Procesverbalin e datës 09.07.2024, të A.B; Procesverbalin e datës 09.07.2024, të F.F; Procesverbalin e datës 09.07.2024, të H.H; Deklaratën e ankuesit të datës 06.07.2024; Deklaratën e datës 06.07.2024, të A.Xh, N.A, N.Q, F.B, M.Z, Sh.F, I.S, V.A, V.Gj; Procesverbalin e datës 09.07.2024, të V.Gj; Procesverbalin e datës 09.07.2024, të V.A; Procesverbalin e datës 11.07.2024, të B.K; Procesverbalin e datës 11.07.2024, të M.I; Procesverbalin e datës 11.07.2024 të Xh.B; Formularët e rezultateve të punës të datës 10.01.2024; datës 15.01.2023 dhe të datës 07.01.2022.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pa bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesi sipas Kontratës së Punës së datës 15.07.2020, është i punësuar në pozitën *Zyrtar Korrektues*, në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë, në kuadër të ShKK-së.

Tutje sipas shkresave të lëndës, rrjedhë se Udhëheqësi për Punë Juridike dhe të Përgjithshme, në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë, përmes shkresës me numër protokolli 000448/24 të datës 06.07.2024, ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj ankuesit, për shkak të supozimit për moskryerje të detyrave të punës në Dhomën e Kontrollit, me rastin e Largimit (Arratisjes) të të dënuarit F.H nga

QK në Smrekonicë, përkatësisht për shkelje të rregullave të punës, të përcaktuar sipas Nenit 58, paragrafit 3 nën paragrafit 3.11 dhe 3.12, dhe dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht Nenit 56 paragrafit 4 nën paragrafit 4.1.

Komisioni Disiplinor i ShKK-së, pas pranimit të shkresës së lartë theksuar lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore, në po të njëjtën datë, ka nxjerrë Vendimin KD.nr.014/24, me të cilin ankuesin e ka pezulluar përkohësisht nga puna, për shkak të dyshimit të shkeljes së rëndë disiplinore, të parashikuar me nenin 58 paragrafi 3 nën paragrafi 3.11 dhe 3.12, të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës si dhe nenit 56 paragrafit 4 nën paragrafi 4.1, të Ligjit Nr. 08/L-187 për Zyrtarët Publik, për shkak se besohet se ka arsye se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga ankuesi, për të cilin ka filluar procedura disiplinore lidhur me rastin e dyshimit të arratisjes së të burgosurit F.H, e pengon hetimin disiplinor apo mund të cenoj ushtrimin e përshtatshëm të detyrës.

Tutje, Komisioni Disiplinor i ShKK-së, bazuar në nenin 85 paragrafin 1 dhe 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 69 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 59 paragrafin 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe bazuar në raportin Nr.Ref:08/1-01-871/2024 DKR, të datës 07.08.2024, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, më datë 15.08.2024, ka nxjerrë Vendimin KD.nr.14/2024, përmes të cili akt ka pezulluar procedurën e iniciuar disiplinore ndaj ankuesit, ndërsa ka lënë në fuqi Vendimin KD.nr.014/24 të datës 06.07.2024, me arsyetimin se ShKK, lidhur me rastin e arratisjes së të paraburgosurit në fjalë, ka pranuar kërkesë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, përmes së cilës ka njoftuar se lidhur me rastin janë duke u zhvilluar hetime me autorizim të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.

Ndërsa, Komisioni Disiplinor i ShKK-së, bazuar në nenin 83 paragrafin 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më datë 11.02.2025 ka nxjerrë Vendimin KD.nr.014/015/016/2024, përmes të cilit ka aktivizuar procedurat disiplinore KD.nr.014,015, 016/2024 të datës 15.08.2024, e pezulluar sipas Vendimit të lartë theksuar, me shifër KD.nr.014/24, për arsye se më datë 06.01.2025, Komisioni ka pranuar Aktvendimin me numër të lëndës 2024:0043375, të Prokurorisë Themelore Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, Prokurori i Shtetit, me të cilin aktvendim ka pushuar procedura penale dhe hetimet e filluara sipas Aktvendimit PP.II.nr.1186/24 të datës 18.07.2024, mbi bazën e kallëzimeve penale të paraqitura nga Stacioni Policor-Vushtrri, me nr. rasti 2024-BD-608 të datës 12.07.2024 dhe ShKK-së të datës 08.07.2024, kundër të pandehurit F.H.

Andaj, Komisioni Disiplinor i ShKK-së, më datë 18.02.2025, ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli KDI 14/2024, përmes të cilit akt ankuesin e ka shpallë përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore, të paraparë me nenin 58, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1, 3.11 dhe 3.12 të Ligjit Nr.08/L-031 për Shërbimin Korrektues të Kosovës si dhe nenit 56, paragrafit 4, nën paragrafit 4.1, 4.4 dhe 4.20 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, duke i shqiptuar të njëjtit masën disiplinore të përcaktuar nga neni 57, paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 të këtij ligji dhe nenit 15, paragrafit 3, nën paragrafit 3.5 të Rregullores Nr.01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, *“Pezullim nga pozita pa pagesë për gjashtë (6) muaj”*.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Vendimi me numër protokolli KDI 14/2024, i datës 13.02.2025, është nxjerrë përmes aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, shkeljes së dispozitave procedurale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, duke theksuar ndër të tjera se akti i kontestuar nuk i përmban elementet e parapara nga neni 47 dhe si i tillë është i pa ligjshëm në kuptim të nenit 52 të LPPA-së, se Komisioni Disiplinor, dhe se po ashtu Komisioni nuk ka marrë për bazë asnjë rrethanë lehtësues tije, dhe si për rrjedhojë kërkon nga Këshilli, aprovimin e ankesës, anulimin e vendimit në fjalë dhe kthimin e ankuesit në vendin e punës me të gjitha të drejtat, duke përfshirë kompensimin e pagave të humbura ose zëvendësimin e masës disiplinore me ndonjë masë më të lehtë.

Kolegji i Këshillit në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, ku përcaktohet se : *“1. Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues dhe sprovues të Kosovës”* paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 dhe 2.7, ku përcaktohet se : *“2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.6. përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimi”* si dhe nenit 3, ku përcaktohet se : *“3. Ne rast të rregullimit me ligj të veçantë, për shërbyesin civil me status të veçantë - dispozita mbizotëruese janë dispozitat e ligjit të veçantë.”*

Referuar përcaktimeve ligjore të sipër theksuara, Kolegji konstaton se të punësuarit në Shërbimin Korrektues të Kosovës kanë statusin e veçantë të nëpunësit civil, kështu Ligji Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, gjegjësisht Neni 58 dhe 59 ka rregulluar çështjet e disiplinës dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil të ShKK-së, ndërsa me Nenin 59 paragrafi 2, shprehimisht përcaktohet se procedura disiplinore zhvillohet në pajtim me ligjin për zyrtarët publikë, dhe për rrjedhojë me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht Nenin 55 paragrafi 1, i cili përcakton se: *1. Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim. Nenin 56 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, paragrafin 2 si dhe paragrafin 4 nën paragrafin 4.1, 4.4 dhe 4.20, ku përcaktohet se: 1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.2. shkelje të rënda. 2. Shkeljet e rënda të detyrave dhe përgjegjësi të punës janë të përcaktuara me ligj, ndërsa shkeljet e lehta janë të përcaktuara me ligj dhe rregulla të brendshme. 4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi, Nenin 57 paragrafin 1, paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 ku përcaktohet se: 1. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunëses/it civil për shkelje të lehta janë: 2. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunëses/it civil për shkelje të rënda janë; 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; Nenin 58 paragrafin 2, ku përcaktohet se: 2. Masat disiplinore për shkeljet e rënda shqiptohen nga komisioni disiplinor, Nenin 59, paragrafi 1 dhe*

paragrafi 3, ku përcaktohet se: 1. *Procedura disiplinore fillon mbi bazën e dyshimit të bazuar për shkeljen e detyrave dhe përgjegjësi të punës nga nëpunësja/i civil, duke mos përjashtuar informatat e pranuar në mënyrë anonime.* 2. *Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore për shkeljen e detyrave dhe përgjegjësi të punës nga nëpunësja/i civil.* 3. *Komisioni disiplinor fillon procedurën: 3.1. me kërkesë të mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë të nëpunës/it civil; 3.2. bazuar në të gjeturat dhe/apo rekomandimet e çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtareje/i tjetër brenda institucionit, si dhe me kërkesën e qytetares/it; 3.3. me nismën e çdo anëtare/i të komisionit, mbi bazën e dyshimit të bazuar për kryerjen e një shkeljeje disiplinore, si dhe paragrafin 1 të Nenit 61, ku përcaktohet se: 1. Për përcaktimin e masës disiplinore mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 62 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunës/it për shmangien apo kufizimin e dëmit.*

Bazuar në kuadrin ligjorë si më sipër e duke ju referuar edhe nenit 86 të LPPA-së, Kolegji i Këshillit ka analizuar vendimin e kundërshtuar me ankesë, në ndërlidhje me provat materiale të kësaj çështje administrative, e duke marrë parasysh konstatimin nga Raportin e Inspektoratit të Drejtësisë, me numër protokolli 592, të datës 08.07.2024, mbi të cilin rrjedhë se Inspektorati përkatës ka shiquar inqizimet nga kamerat e sigurisë Qendrës Korrektuese përkatëse, duke përshkruar ngjarjen apo arratisjen e ish të burgosurit, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtave ka gjetur se Komisioni Disiplinor ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike dhe përgjegjësinë disiplinore të ankuesit, për arsye se i njëjti, në cilësinë e Zyrtarit Korrektues në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë, natën e arratisjes së ish të burgosurit apo më saktësisht më datë 05-06.07.2024, nga ora 18:45 deri më 07:00, ankuesi ka qenë i caktuar për kryerjen e detyrave të punës në dhomën e kontrollit dhe monitorimit të kamerave, mirëpo një i burgosur ka arritur të arratiset nga Qendra Korrektuese, pa u vënë fare re nga ankuesi, nga rezulton se i njëjti me këtë rast nuk ka arritur t'i përmbush obligimet ligjore për kryerjen e detyrave funksionale dhe përgjegjësi të pozitës së tij të punës, apo thënë më konkretisht ka dështuar të monitoroj lëvizjet e të burgosurve.

Ndërsa sa i përket pretendimet ankimor të ankuesit, se Komisioni Disiplinor nuk ka marrë për bazë rrethana lehtësuese, për shkak të ndërrimit 12 orësh dhe pamundësisë që të bëhet monitorimi i të gjitha kamerave të sigurisë, ngase janë 8 monitorë dhe 120 kamera, Kolegji i Këshilli nga shkresat e lëndës, të bashkangjitura nga ankuesi dhe organi i punësimit, nuk ka gjetur asnjë dëshmi konkrete se ankuesi ndonjëherë, ka kërkuar ndryshimin apo shkurtimin e orarit të punës ose shtimin e zyrtarëve për kryerjen e kësaj detyre të punës apo monitorimit të kamerave, andaj edhe pretendimet ankimore të ankuesit të parashtruara në ankesë janë të pa qëndrueshme, dhe si të tilla nuk e lirojnë të njëjtin nga përgjegjësia disiplinore për shkeljet e rënda të detyrave të punës.

Andaj, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi në cilësinë e mbikëqyrësit të kamerave në ditën e arratisjes së të burgosurit, mbanë përgjegjësi për mos marrje të veprimeve konkrete për rastin e caktuar, gjegjësisht i njëjti për këto veprime është përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore që kanë të bëjnë me detyrat e përcaktuara ligjore dhe për rrjedhojë Komisioni Disiplinor i Shërbimit

Korrektues të Kosovës, ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plot gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejt ligjin material, kur ka vendosur se ankuesi është përgjegjës për shkelje disiplinore të parapara me nenin 58, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1, 3.11 dhe 3.12 të Ligjit Nr.08/L-031 për Shërbimin Korrektues të Kosovës si dhe nenit 56, paragrafit 4, nën paragrafit 4.1, 4.4 dhe 4.20 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik. Ashtu që duke marr parasysh këtë, Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi i kontestuar me ankesë është nxjerr në pajtim me nenin 55 paragrafi 1, nenin 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.4 dhe 4.20, nenin 57 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5, nenin 58 paragrafi 2, nenin 61 paragrafi 1, 2 dhe 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, si dhe i njëjti përmban elementet e aktit juridik të parapara me nenin 47 të Ligjit Nr.08/L-197 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Prandaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.451/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, Avokatit Jetullah Aliu;
- Shërbimit Korrektues të Kosovës (Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.